



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:264813
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05486094

C.nr.3848/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.B. me numër personal me vendbanim në rr.”.....” në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqësonë av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Arsimit dhe Shkencës me seli në Prishtinë, me objekt të padisë kompensimi i shujtës, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I.** APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.B. nga Prizreni.
- II.** DETYROHET e paditura, M.A.Sh. me seli në Prishtinë, që paditëses E.B. nga Prizreni, në emër të shujtave ditore për 150 ditë pune për vitin 2022 (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), ti paguaj shumën e përgjithshme prej 300.00 (treqind) euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 16.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III.** DETYROHET e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 (njëqind e njëzetë e katër) euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja E.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj avokat A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, me datën 16.11.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës M.A.Sh. me seli në Prishtinë, me objekt të padisë kompensimin e shujtave.

I autorizuari i paditësit në padi, ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune pranë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Lef Nosi” në Prizren. Ndërsa gjatë vitit 2022 për periudhën prej dt. 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022, pranë të paditurës ka qenë në punë në 150 ditë pune andaj në kuptim të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të dt. 22.02.2021 e paditura i ka mbetur borxh paditëses në shumë prej 300.00 euro dhe në këtë kuptim ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar.
Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Kërkesëpadia e paditëses është mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe në bazë të nenit 90 të Ligjit të Punës, kohëzgjatja e kësaj kontrate është 3 vite. Ka shtuar se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë 01B/2056 e dt.18.04.2017 është shfuqizuar me nenin 74 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë numër 01B/105 të dt.22.01.2021, gjithashtu duke u bazuar në faktin se MASHT është tërhequr nga kjo kontratë si e tillë kjo kontratë më nuk gjen zbatim. Paditësja me asnjë provë nuk ka dëshmuar se është anëtare e SBASHK, siç parashihet me dispozitën e nenit 35 par.5,7 dhe 11 të KKS-së. Gjithashtu e paditura ka shtuar se bazuar në nenin 341 të LMD-së ku është paraparë “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Andaj, e paditura me të gjitha të cekurat si më lartë ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi e pa bazuar apo të hudhet si e pa lejuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Lef Nosi” në Prizren.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 89, të datës 16.10.2023, të lëshuar nga Drejtoresha e Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Lef Nosi” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Edona Bekçeli nga Prizreni, është në marrëdhënie pune si mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2022, dhe atë nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 150 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, gjykata i’a fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “*Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...*”.

Në këtë drejtim e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si punëtore e arsimit-mësimdhënës, t'ia paguaj kompensimin e shujtave, ngase përmes vërtetimit të prezencës në punë është vërtetuar se paditësja për vitin 2022, për periudhën nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, ka realizuar gjithsej 150 ditë pune që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 300 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 150 me 2 euro (150 x 2 euro = 300 euro). apo shuma e përgjithshme prej 300.00 (treqind) euro.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (16.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3848/2023, datë 21.03.2024

G j y q t a r j a
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.